

VENDIM
Nr.440, datë 10.10.1992

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.310,
DATË 24.7.1992 " PËR KOMPENSIMIN PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA
RRITJA E ÇMIMEVE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË "**

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992 "Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë", bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I, në pikën 1, pas shkronjës "d" shtohen shkronja "e" me këtë përmbajtje:
"Ushtarakëve të shërbimit aktiv të përhershëm dhe atyre të dalë në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".
2. Shkronjat "b" dhe "c" të pikës 2 të kreut I shfuqizohen.
3. Në pikën 5 të kreut II hiqen fjalët: "Ushtarakët e shërbimit aktiv".
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi